



# ANGAZHIMI NË KONSULTIME PUBLIKE

Udhëzues për shoqërinë civile mbi përpjekjet konsultative dhe të avokimit gjatë proceseve të bërjes së politikave dhe ligjeve

# ANGAZHIMI NË KONSULTIME PUBLIKE

Udhëzues për shoqërinë civile mbi përpjekjet konsultative dhe të avokimit gjatë proceseve të bërjes së politikave dhe ligjeve

# I. HYRJE

## 1. Udhëzuesi dhe qëllimi i tij

1. Ky udhëzues u përgatit për të ofruar një pasqyrë të standardeve dhe parimeve ndërkombëtare dhe vendore mbi konsultimet publike dhe përpjekjet e avokimit gjatë proceseve të hartimit të ligjeve dhe politikave brenda Qeverisë. Qëllimi i tij kryesor është të ofrojë udhëzime për shoqërinë civile se si të angazhohen në proceset e konsultimit në Kosovë, duke ndjekur sidomos miratimin e Rregullores së Qeverisë 5/2016 mbi Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik, më 29 prill 2016 (në tekstin e mëtejshëm: "Rregullorja e Qeverisë Nr. 5/2016").

## 2. Përkufizimi i konsultimeve publike

2. Një nga gjërat e para që duhet të përcaktohet në këtë kontekst është se çka janë konsultimet publike. Përderisa nuk ka përkufizim ndërkombëtar që do të ishte i zbatueshëm për të gjitha vendet dhe situatat, proceset e konsultimit publik kuptohen përgjithësisht si çdo ndërveprim midis organeve përgjegjëse për ligjin dhe politik-bërjen dhe palëve që ka të ngjarë të preken nga, ose janë të interesuara për rregulloren ose politikën në fjalë<sup>1</sup>, duke përfshirë publikun e gjerë.

3. Në Kosovë, neni 3, par. 1.1 i Rregullores së Qeverisë Nr. 5/2016 që përcakton standardet minimale për konsultimet publike përshkruan procesin e konsultimit publik si

*"Pjesëmarrja e palëve të interesuara dhe publikut në procesin e vendim-marrjes së organeve publike, pas shpalljes së bërë nga organi publik përgjegjës"*

4. Të dy përkufizimet tregojnë se nocioni i konsultimeve publike është mjaft i gjerë dhe përfshin shumë mjete dhe lloje të ndryshme të konsultimeve. Element i rëndësishëm këtu është komunikimi ndërmjet organeve publike që përgatisin politika dhe ligje, dhe palëve të interesit dhe publikut të gjerë, në cilëndo formë.

## 3. Konsultimet publike në proceset e hartimit të politikave dhe ligjeve

5. Konsultimet publike janë një element i rëndësishëm i proceseve ku qeveritë dhe institucionet e tjera publike që hartojnë politika dhe ligje

---

<sup>1</sup> Grupi Mandelkern mbi Rregullimin më të Mirë (e themeluar më 7 nëntor 2000 nga Ministri e BE-së përgjegjës për Shërbimin Civil dhe Administratën Publike), *Raporti Përfundimtar*, nëntor 2001, faqe 26, në dispozicion në [http://ec.europa.eu/smart-regulation/better\\_regulation/documents/mandelkern\\_report.pdf](http://ec.europa.eu/smart-regulation/better_regulation/documents/mandelkern_report.pdf)

planifikojnë, përgatisin, debatojnë, konsultojnë dhe përfundimisht miratojnë politika ose ligje.

6. Ky proces është i vazhdueshëm – pasi që një politikë ose ligj është miratuar, vlerësimi i tij mund të çojë në diskutim të një politike ose ligji të ri, ose të ndryshuar. Diagrami më poshtë tregon natyrën rrethore të diskutimeve të politikave:



7. Në këtë proces, konsultimet publike janë thelbësore në fillim, kur debatohen opsione të ndryshme për zgjidhjen e një çështjeje, por edhe atëherë kur një propozim legjislativ është i përgatitur. Gjatë gjithë ciklit të politikave, palët e interesuara, ekspertët dhe publiku i gjerë duhet të informohen dhe të kenë mundësinë të thonë fjalën e tyre. Është gjithashtu e rëndësishme të përfshihet publiku dhe aktorët kryesorë në diskutimet mbi atë se si zbatohen politikat/ligjet e miratuara dhe nëse ka nevojë për ndryshime apo politika/ligje të reja.

## II. STANDARDET NDËRKOMBËTARE

### 1. Neni 25 i KNDCP-së

8. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP) është një nga traktatet kryesore të të drejtave të njeriut, me shtrirjen më të gjerë në aspektin e zbatueshmërisë. Në Kosovë, kjo Konventë është e zbatueshme drejtpërdrejt, në pajtim me nenin 22 paragrafi 3 të Kushtetutës, që gjithashtu thekson se këto instrumente ndërkombëtare kanë përparësi mbi ligjin ose aktin e një institucioni publik të Kosovës.<sup>2</sup>

<sup>2</sup> Kjo në thelb do të thotë se nëse një ligj apo veprim i qeverisë thotë diçka ndryshe nga ajo që është shkruar në instrumentet ndërkombëtare të renditura në nenin 22 të Kushtetutës, atëherë formulimi i instrumenteve ndërkombëtare duhet të ndiqet pa marrë parasysh - ligji i brendshëm do të duhet të ndryshohet, dhe veprimi i qeverisë nuk do të jetë i vlefshëm.

*Neni 25 i KNDCP-së thekson se:*

*Çdo qytetar ka të drejtën dhe mundësinë, pa asnjë dallim të përmendur në nenin 2 dhe pa kufizime të paarsyeshme:*

*(a) Të marrë pjesë në kryerjen e punëve publike, drejtpërdrejt ose nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur lirisht; [...]*

9. Kështu, në vendet që kanë ratifikuar Konventën, çdo qytetar do të ketë të drejta dhe mundësi të barabarta për të marrë pjesë në çështjet publike vendore, qoftë drejtpërdrejt, apo nëpërmjet Qeverisë ose Parlamentit.

10. Çështjet publike nënkuptojnë çdo çështje që ka të bëjë me pushtetin politik - qytetarët mund të marrin pjesë në aktivitetet e Qeverisë (duke përfshirë çdo zyrë administrative publike) dhe të Parlamentit. Kjo e drejtë shtrihet edhe në çështjet publike në nivelin lokal/komunal.<sup>3</sup> Në mënyrë ideale, këto të drejta duhet të shkruhen qartë në Kushtetutë dhe në legjislacionin përkatës.<sup>4</sup>

11. Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë në kryerjen e punëve publike në thelb nënkupton që të drejtat e qytetarëve për të marrë pjesë nuk janë të kufizuara në votim - ata gjithashtu kanë të drejtë të përpiqen të ndikojnë në veprimet e Qeverisë, ose në politika dhe ligje që miratohen, duke marrë pjesë drejtpërdrejt në diskutime, qoftë si individë, ose si shoqata,<sup>5</sup> p.sh. si OJQ apo grupe të interesit. Kjo nuk do të thotë që çdo qytetar do të jetë në gjendje të ndikojë në punën e Qeverisë dhe Parlamentit - në demokracitë përfaqësuese, vullneti i shumicës, ose një formë e *Real-politikës* mund të mbizotërojë. Megjithatë, qytetarët duhet të kenë mundësinë të marrin pjesë, dhe përfaqësuesit publik, qoftë zyrtarë qeveritar ose deputet, duhet të mbështesin të gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë në këtë.

## **2. Bashkimi Evropian**

12. Edhe pse Kosova nuk është anëtare e Bashkimit Evropian (BE), ajo ka nënshkruar një marrëveshje stabilizim-asociimi me BE-në, dhe për këtë arsye duhet të sigurojë që ligjet dhe politikat e saj të jenë në përputhje me kërkesat dhe dokumentet e BE-së. Traktati mbi Bashkimin Evropian i detyron institucionet e BE-së që t'i "japin qytetarëve dhe shoqatave përfaqësuese mundësinë për të bërë të njohur dhe shkëmbyer publikisht pikëpamjet e tyre në të gjitha fushat e veprimit "; kjo nënkupton një dialog të hapur, transparent dhe të rregullt me shoqatat përfaqësuese dhe shoqërinë civile<sup>6</sup>. Kjo do të nënkuptonte që edhe vendet anëtare të BE-së, dhe ato që përpiqen të bëhen anëtarë një ditë, duhet të përpiqen dhe të ndjekin standarde të ngjashme mbi konsultimet publike dhe transparencën.

<sup>3</sup> Shikoni Komentin e Përgjithshëm Nr. 25: E drejta për të marrë pjesë në çështjet publike, të drejtat e votimit dhe të drejtat për qasje të barabartë në shërbimin publik (neni 25), miratuar nga Komiteti i Drejtave të Njeriut i KB-së më 12 korrik 1996, paragrafi 5

<sup>4</sup> Ibid. Në Kosovë, përmbajtja e nenit 25 të KNDCP-së reflektohet pjesërisht në nenin 45 të Kushtetutës, shih sidomos par. 3: "Institucionet shtetërore mbështesin mundësinë e çdo personi për të marrë pjesë në aktivitetet publike, dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike."

<sup>5</sup> Komentin e Përgjithshëm Nr. 25, par 8.

<sup>6</sup> Shikoni nenin 11 par. 1 dhe 2 të Traktatit mbi Bashkimin Evropian.

### 3. Dokumente/Udhëzues tjerë ndërkombëtarë

13. Një numër i organizatave të tjera ndërkombëtare kanë zhvilluar udhëzime dhe mjete për zhvillimin e konsultimeve publike, veçanërisht Këshilli i Evropës (KiE), Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OBZHE), dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).

14. Në nivelin e Këshillit të Evropës, Kosova është gjithashtu anëtare e Komisionit Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venedikut). Kjo do të thotë se një përfaqësues i caktuar i Kosovës merr pjesë në takimet dhe aktivitetet e Komisionit të Venedikut, dhe projektligjet e saj mund të rishikohen, sipas kërkesës, nga ekspertët e Komisionit të Venedikut (që vlerësojnë përputhshmërinë e legjislacionit vendas me traktatet ndërkombëtare). Ndërsa opinionet e Komisionit të Venedikut janë thjesht këshilluese në natyrë, gjatë viteve të fundit, ato kanë theksuar gjithnjë e më shumë rëndësinë e debatit publik para miratimit të legjislacionit, dhe kanë përfshirë rekomandime për shtetet që të angazhohen në debat të mëtejshëm gjatë përgatitjes së legjislacionit.<sup>7</sup>

15. Disa dokumente që mund të jenë të dobishme dhe që janë përgatitur nga organizatat e mësipërme mund të ofrojnë udhëzime shtesë për konsultimet publike:

- KiE - Kodi i praktikave të mira për pjesëmarrjen qytetare në procesin e vendim-marrjes (2009);
- Doracaku i OBZHE-së mbi informimin, konsultimin dhe pjesëmarrjen e publikut në hartimin e politikave;
- Udhëzimet e OBZHE-së për konsultimet publike online;
- Udhëzimet e BE-së për konsultimin e palëve të interesuara; dhe
- Rekomandimet për përforsimin e pjesëmarrjes së asociacioneve në proceset vendim-marrëse publike (2015) të përgatitura nga ekspertët e shoqërisë civile me mbështetjen e Zyrës së OSBE-së për institucionet demokratike dhe të drejtat e njeriut.

## III. KORNIZA LIGJORE NË KOSOVË

### 1. Kushtetuta

16. Në Kushtetutë, liria e zgjedhjes dhe pjesëmarrjes përcaktohet në nenin 45.

*Neni 45 paragrafi 3 i Kushtetutës thekson se:*

*"Institucionet e shtetit mbështetin mundësinë e çdo personi për të marrë pjesë në aktivitetet publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike."*

<sup>7</sup> Shikoni, si një shembull të fundit, Opinionin e Komisionit të Venedikut mbi Projektligjin e Hungarisë për Transparencën e Organizatave që Marrin Mbështetje nga Jashtë, CD-AD (2017)015, miratuar nga Komisioni i Venedikut në seancën e saj të 111-të plenare (16-17 qershor 2017), par. 25-28

17. Për dallim nga neni 25 të KNDCP-së, kjo dispozitë në Kushtetutën e Kosovës nuk flet në mënyrë eksplicite për të drejtën e pjesëmarrjes në aktivitete publike, por për të drejtën e "ndikimit demokratik në vendimet e organeve publike". Kjo e drejtë duhet të zbatohet për të gjithë, jo vetëm për qytetarët (në krahasim me të drejtën e votës, të cilën Neni 45 par. 1 ua jep vetëm qytetarëve).

18. Në të njëjtën kohë, pjesa e parë e nenit 45 par. 3 të Kushtetutës i detyron institucionet publike të mbështesin mundësinë e çdo personi për të marrë pjesë në çështjet publike, që më gjasë nënkupton se organet publike jo vetëm që duhet të lejojnë të gjithë personat të marrin pjesë, por duhet dhe t'i ndihmojnë ata në këtë, për të siguruar që çdo person ka mundësi të barabarta për të marrë pjesë.

19. Aktivitetet publike të përmendura në nenin 45 par. 3 gjithashtu përfshijnë politik-bërjen dhe ligj-bërjen. Sipas nenit 79 të Kushtetutës, 10 000 qytetarë mund të iniciojnë një projektligj (përveç Presidentit, Qeverisë dhe deputetëve të Kuvendit), siç parashihet me ligj, që është një mjet tjetër për pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në çështjet publike. Lidhur me vetë procesin legjislativ, baza për pjesëmarrje, duke përfshirë konsultimet publike, përsëri do të ishte Neni 45 par. 3 i Kushtetutës.

## **2. Ligji për nisma legjislative**

20. Ligji për nisma legjislative përcakton procedurat për fillimin e legjislacionit për zbatim të nenit 79 të Kushtetutës. Në lidhje me të drejtën e 10 000 qytetarëve për të filluar legjislacionin, nenet 10-21 japin më shumë detaje mbi hapat e ndryshëm që duhet të ndërmerren.

21. Sipas nenit 10 të Ligjit për nisma legjislative, çdo qytetar mund të fillojë një iniciativë të tillë legjislative dhe ka të drejta të barabarta në këtë kontekst. Ekzistojnë dy lloje nismash legjislative - qytetarët mund të hartojnë ligjin vetë, ose mund të propozojnë hartimin e një ligji nga Kuvendi (neni 12). Në të dyja rastet, përfaqësuesi i iniciativës shpall qëllimin dhe objektivin e ligjit të ardhshëm në Kuvend (neni 13); pas këtij njoftimi, brenda gjashtë muajve duhet të mblidhet numri i nevojshëm prej 10 000 nënshkrimeve, dhe iniciativa duhet paraqitur në Kuvend (neni 14). Nëse Kuvendi e pranon iniciativën, atëherë do të pasojë procesi i zakonshëm legjislativ. Nëse jo, atëherë përfaqësuesi i iniciativës mund të ankohet kundër këtij vendimi në gjykatën kompetente administrative (neni 19).

22. Në këto raste, qytetarët përkatës që kanë nisur iniciativën duhet gjithashtu të konsultohen me publikun e gjerë dhe aktorët kyç - si në hartimin e iniciativës së tyre (dhe ndoshta në projektligjin e tyre), dhe për të mbledhur numrin e nevojshëm të nënshkrimeve. Parimet e paraqitura më poshtë në Seksionin IV, të cilat gjithashtu përfshijnë informata për rolet dhe detyrimet e autoriteteve që iniciojnë politika dhe ligje, do të zbatohen për ta në përputhje me rrethanat.

### **3. Rregulloret e Punës së Qeverisë dhe Kuvendit, dhe Rregullorja e Qeverisë Nr. 5/2016**

23. Qeveria dhe Kuvendi ndjekin rregulla specifike të procedurës që përcaktojnë proceset e tyre të punës. Përderisa fokusi i këtij Udhëzuesi është procesi i bërjes së ligjeve dhe politikave brenda Qeverisë, është përfshirë edhe një njoftim i shkurtër me Rregulloren e Punës së Kuvendit, për të demonstruar rolin e saj në ciklin legjislativ.

#### **3.1 Qeveria**

24. Për këtë qëllim, Qeveria miratoi Rregulloren Nr. 9/2011 që përcakton rregullat e saj të procedurës. Kjo Rregullore rregullon procedurat e punës dhe vendimmarrjes së Qeverisë, rregullat dhe procedurat e hartimit të legjislacionit dhe të rekomandimeve të politikave nga Qeveria dhe ministritë, si dhe organizimin e mbledhjeve të Qeverisë dhe punën e komiteteve ministrore.

25. Brenda Kapitullit IV të Rregullores mbi rregullat që drejtojnë zhvillimin e politikave dhe procesin e analizave të politikave, ekziston dhe një dispozitë e veçantë për konsultimet publike (neni 32), përveç nenit 7 që rregullon konsultimet paraprake në Kapitullin II.

26. Për më tepër, neni 69 në përgjithësi kërkon që Qeveria të bashkëpunojë me aktorë të ndryshëm, përfshirë OJQ-të dhe shoqatat tjera. Sipas par. 2 të kësaj dispozite, Qeveria duhet që "në veçanti të debatojë opinionet dhe nismat e tyre, të merr qëndrim ndaj tyre, të i njoftojë ato për qëndrimet dhe masat e saj, dhe, kur është e nevojshme, i fton përfaqësuesit e tyre që të marrin pjesë në mbledhjet e organeve të punës të Qeverisë, dhe të organizojë forma të tjera të bashkëpunimit."

27. Përveç Rregullores së Punës së Qeverisë dhe dispozitave të saj për konsultimin publik dhe bashkëpunimin me shoqërinë civile, Qeveria miratoi kohët e fundit Rregulloren Nr. 5/2016 për *Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik*. Sipas nenit 1 të kësaj Rregulloreje, qëllimi i saj është të promovojë dhe sigurojë procese gjithëpërfshirëse të konsultimit publik ndërmjet autoriteteve publike dhe palëve të interesuara dhe publikut, si dhe të rrisë transparencën dhe llogaridhënien e organeve publike. Në këtë kontekst, Rregullorja e Qeverisë Nr. 5/2016 përcakton standardet, parimet dhe procedurat minimale të proceseve të konsultimit publik në hartimin e politikave dhe legjislacionit (neni 1 par. 2). Këto do të zbatohen për të gjitha organet publike dhe për të gjitha dokumentet që kërkojnë konsultime publike.

#### **3.2 Kuvendi i Kosovës**

28. Sikurse Qeveria, Rregullorja e Punës së Kuvendit gjithashtu përmban dispozita për konsultimet publike. Këto Rregulla të Punës përcaktojnë organizimin e brendshëm dhe mënyrën e punës së Kuvendit.



29. Neni 66 i Rregullores së Punës së Kuvendit thotë që, për të marrë informata mbi një çështje që është në diskutim, komisioni përgjegjës i Kuvendit mund të mbajë dëgjime publike të ekspertëve, organizatave publike, përfaqësuesve të grupeve të interesit, dhe personave të tjerë. Në këtë mënyrë, çdo komision mund të hyjë në një diskutim të përgjithshëm me personin përkatës duke dhënë informata shtesë, për atë që është e nevojshme për të sqaruar faktet.

## **IV. SI TË MERRNI PJESË NË PROCESET PUBLIKE TË KONSULTIMIT DHE AVOKIMIT NË KOSOVË - DISA UDHËZIME**

30. Bazuar në kornizën e mësipërme ligjore, në veçanti rregulloret relevante të Qeverisë, ky seksion synon të ofrojë disa udhëzime se si shoqëria civile dhe publiku i gjerë mund të ushtrojnë të drejtën e pjesëmarrjes në Kosovë në praktikë. Kjo pjesë e Udhëzuesit nuk pretendon të jetë e plotë, dhe mund të përshtatet dhe azhurnohet sipas nevojës.

### **1. Qëllimi i konsultimeve publike**

31. Në thelb, konsultimi me publikun është një mënyrë për të mbledhur informata. Gjatë përgatitjes së një projekt-politike ose projekt-ligji, hartuesit përkatës dhe krijuesit e politikave nuk do të kenë gjithmonë të gjitha informatat në dispozicion të tyre. Konsultimet publike janë një mjet për të plotësuar këto zbrazëti në informata.

32. Një tjetër qëllim i konsultimeve publike është 'testimi i ujërave' – në rastet kur institucionet publike përgatisin një politikë ose një ligj të ri, është e rëndësishme për ata që të dinë nëse masat e imponuara nga politika/ligji do të pranohen nga të gjithë, ose të paktën nga pjesë të mëdha të shoqërisë. Konsultimet publike janë një mjet për të informuar publikun për masat e planifikuara në fillim, ashtu që shqetësimet e mundshme të merren parasysh nga faza fillestare. Gjithashtu, konsultimet publike ndihmojnë që legjislacioni të zbatohet në mënyrë të duhur në fund – duke bërë pyetje tek palët e interesuara, ekspertët dhe publiku, gabimet në hartim mund të shmangen, dhe ligji ose politika përfundimtare e miratuar do të përshtatet në mënyrë adekuate me realitetin në terren.

### **2. Vështrim i përgjithshëm procedural**

33. Konsultimet publike janë pjesë e procesit të gjerë të bërjes së politikave dhe ligjeve në kuadër të Qeverisë. Diagrami më poshtë përshkruan fazat kryesore të këtij procesi, siç përcaktohet në Rregulloren e Punës së Qeverisë dhe në Rregulloren Nr.5/2016.



### 3. Sigurimi i informatave të nevojshme para dhe gjatë konsultimeve

34. Për të marrë pjesë në konsultime publike, hapi i parë i rëndësishëm është të marrësh informacion mbi draft-politikat dhe ligjet aktuale që po diskutohen. Kjo bëhet më së miri duke hyrë në platformën online të konsultimit të krijuar

nga Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit:  
<http://konsultimet.rks-gov.net>

35. Kjo faqe interneti ofron informata mbi konsultimet në vazhdim, si dhe për kuadrin ligjor dhe planet vjetore të punës së Qeverisë (duke përfshirë planin vjetor legjislativ dhe listën e strategjive). Konsultimet përkatëse mund të kërkohen sipas ministrisë/zyrës publike, dhe ato të vazhdueshme janë të numëruara nën "konsultimet e fundit" – informatat për konsultimet përfshijnë dokumentet e ngarkuara relevante për procesin, dhe detajet e kontaktit të zyrtarit përgjegjës brenda ministrisë/zyrës.

Kategoria	Numri
UDHEZIME	71
RREGULLORE	35
PLANE VEPRIMI	19
LIGJE	6
KONCEPT DOKUMENTE	6

Faqja e internetit gjithashtu përmban statistika për numrin e konsultimeve që janë ndërmarrë që nga nisja e platformës në shkurt 2017, të cilat përditësohen rregullisht. Për të marrë pjesë në konsultimet publike të një ministrie/zyre apo fushe tematike, organizatat e shoqërisë civile dhe anëtarët e publikut mund të kërkojnë të regjistrohen edhe nëpërmjet platformës.

36. Kërkesa për të krijuar një platformë të tillë gjendet në Nenin 12 të Rregullores së Qeverisë Nr. 5/2016. Sipas nenit 12 paragrafët 4 dhe 5, publiku dhe palët e interesuara duhet të shprehin dëshirën e tyre për të marrë pjesë në konsultime publike në platformën online të Qeverisë në baza vjetore, ose kur planet e punës së organeve publike po ndryshohen ose plotësohen, duke identifikuar njësinë/projektin e qeverisë me të cilin ata duan të përfshihen. Platforma online gjithashtu mund të përfshijë platforma përmes të cilave publiku/palët e interesuara dhe autoriteti publik përkatës mund të komunikojnë (par. 6). Kur regjistroheni për një profil përdoruesi, individëve u kërkohet të paraqesin disa informata bazë. Neni 12 paragrafët 8 dhe 9 theksojnë që asnjë informatë shtesë nuk mund të kërkohet dhe se informatat e dhëna nuk mund të përdoren për të diskriminuar ose përjashtuar ndonjë palë të interesuar ose anëtar të publikut.

37. Në praktikë, për të marrë informata mbi konsultimet e ardhshme publike, ndoshta do të ishte më mirë që të konsultohet plani vjetor i punës së Qeverisë, strategjia vjetore legjislative dhe lista e koncept-dokumenteve, dhe pastaj të kërkohen informata për projekt-politikat ose ligjet e planifikuara specifike të përcaktuara aty nga ministritë përgjegjëse. Sipas Rregullores së Punës së Qeverisë (neni 29 par. 3), të gjitha projekt-politikat dhe ligjet që kërkojnë koncept-dokumente ose memorandume shpjeguese duhet të kenë konsultime publike. Rregullorja e Qeverisë Nr. 5/2016 është edhe më e qartë dhe liston, në nenin 5, dokumentet që i nënshtrohen konsultimeve publike (shih par. 45 më lart). Përrjashtimet bëhen për dokumente jo-publike të klasifikuara, marrëdhënie ndërkombëtare, dhe marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe, procedurat parlamentare në Kuvend, procedurat që përfshijnë miratimin e dekreteve presidenciale dhe aktet administrative individuale (përveç nëse është përcaktuar ndryshe me ligj) (Neni 17 i Rregullores ).

38. Pasi të fillojë një proces konsultimi, palët e interesuara/anëtarët e publikut të përfshirë duhet të marrin dokumente shtesë/informata për takimet publike nga organi publik organizues. Informata shtesë mund të kërkohen nga zyrtari i listuar si përgjegjës për konsultimin publik.

39. Komunikimi dhe ndërgjegjësimi i drejtuar nga Qeveria duket se konsiston kryesisht në publikimin e informatave në faqen e internetit; nuk ka tregues të programeve shtesë të informimit për të arritur anëtarët e publikut dhe organizatat e vogla dhe më pak të njohura të shoqërisë civile jashtë kryeqytetit dhe qyteteve më të mëdha. Kështu OJQ-të dhe individët duhet të kërkojnë dhe gjejnë informatat përkatëse në platformën online dhe të regjistrohen për pjesëmarrje shtesë. OJQ-të mund të ndihmojnë në arritjen e pjesëve të tjera të shoqërisë civile/publikut duke krijuar rrjete dhe platforma të tyre të diskutimit (shih nën-seksionin 9 më poshtë). Në të njëjtën kohë, përpjekjet për avokim mund të përqendrohen gjithashtu në ngritjen e vetëdijes për nevojën për komunikim të mëtejshëm dhe inkurajim të ministrive dhe zyrave të tjera publike për të kryer një kontakt më pro-aktiv me njerëzit dhe organizatat të cilat janë të pa-favorizuara për shkak të mungesës së njohurive të tyre, ose vendndodhjes së tyre gjeografike.

#### **4. E Drejta për pjesëmarrje në konsultime publike në praktikë**

40. Sipas legjislacionit të zbatueshëm në Kosovë, kushdo mund të kërkojë të ndikojë në mënyrë demokratike në vendimet e autoriteteve publike dhe duhet të mbështetet në këtë nga autoritetet publike. Kjo do të thotë që autoritetet publike duhet të sigurohen që çdo person ose grup personash mund të marrë pjesë në konsultime publike dhe nuk mund të pengojë ose ndalojë askë që ta bëjë këtë, ose të favorizojë/disavantazhojë ndonjë palë të veçantë. Kjo e drejtë për pjesëmarrje publike është e përcaktuar në nenin 45 të Kushtetutës.

41. E drejta për të marrë pjesë në konsultimet publike gjithashtu nënkupton që informata mbi projekt-politikat dhe ligjet e ardhshme duhet të jetë e

kuptueshme për publikun e gjerë, ashtu si duhet të jetë i kuptueshëm edhe ndikimi i tyre në individë dhe grupe të caktuara. Ky informacion duhet të jetë i disponueshëm në të gjitha gjuhët zyrtare të Kosovës (shih Nenin 4 të Rregullores 5/2016). Zyrtarët përgjegjës për organizimin e konsultimeve publike duhet të marrin trajnime dhe këshilla të mjaftueshme dhe të rregullta për të qenë në gjendje të përmbushin detyrat e tyre në mënyrë adekuate. E njëjta vlen edhe për zyrtarët e caktuar brenda ministrive dhe zyrave të tjera publike përgjegjëse për koordinimin e konsultimeve publike (shih Nenin 20 të Rregullores).

42. Këto organe publike publikojnë projekt-propozime në faqet e tyre të internetit, por gjithashtu mund të përdorin forma të tjera të komunikimit për të informuar palët e interesuara dhe publikun (Neni 4 par. 2 i Rregullores së Qeverisë Nr. 5/2016). Përveç kësaj, organet publike duhet të mundësojnë që palët e interesuara dhe publiku janë në gjendje të komentojnë mbi projekt propozimet nga fillimi i procesit (par. 3 i të njëjtit dispozitë).

43. Rregullorja e Qeverisë Nr. 5/2016 përmban dispozita mjaft specifike për përfshirjen e palëve të interesuara dhe publikut në hartimin e planeve vjetore të punës së organeve publike, si dhe të politikave dhe ligjeve (shih Nenin 13 par. 2 dhe 3). Kjo do të thotë që çdo organizatë ose individ i interesuar ka të drejtë të marrë pjesë në këto ushtrime; si minimum, këto konsultime duhet të përfshijnë takime publike, gjatë të cilave do të diskutohen elementet kryesore të projekt-planeve të punës, politikave dhe ligjeve, dhe palët e interesuara / anëtarët e publikut mund të paraqesin mendimet dhe sugjerimet e tyre.

## **5. Cilat lloje të dokumenteve kalojnë konsultimet publike në Kosovë?**

44. Si një standard minimal, dokumentet e mëposhtme do t'i nënshtrohen konsultimeve publike (Neni 5 i Rregullores së Qeverisë Nr. 5/2016):

- Projekt-planet vjetore të organeve publike
- Projekt-planet vjetore të dokumenteve strategjike
- Projekt-programi legjislativ i Qeverisë
- Projekt-plani i akteve nënligjore për vitin përkatës
- Projekt-lista e koncept-dokumenteve për vitin përkatës
- Projekt- koncept-dokumentet e propozimeve për politika ose ligje
- Projekt-aktet normative
- Projekt-strategjitë qeveritare
- Të gjitha dokumentet tjera që duhet të shoqërohen nga një koncept dokument ose memorandum shpjegues

45. Në lidhje me pikën e fundit të koncept-dokumenteve dhe memorandumëve shpjegues, nevoja që propozimet të shoqërohen nga koncept-dokumente është përcaktuar në një udhëzim vjetor të Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit (shih nenin 29 par. 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë). Koncept-dokumentet përcaktojnë çështjen kryesore që adresohet nga një

propozim, objektivat e tij dhe opsionet e ndryshme për zgjidhjen e çështjes (së bashku me pasojat dhe ndikimin fiskal të secilit). Ky dokument pastaj përshkruan opsionin që propozohet, së bashku me arsyetimin përkatës dhe elementët kryesorë të politikës së propozuar (neni 29 paragrafi 5), si dhe informatat për atë se me kënd është konsultuar propozimi dhe kontributi i pranuar (neni 29 par. 5 (9)). Kjo do të përfshinte përmbledhje të rezultateve të konsultimeve publike dhe të konsultimeve me OJQ-të e prekura (Neni 32 paragrafi 3 i Rregullores së Punës së Qeverisë).

46. Në anën tjetër, memorandumet shpjegues janë dokumente të ngjashme që shpjegojnë arsyetimin për përgatitjen e një projekt-politike apo ligji, por nuk kërkojnë informata të detajuara për opsionet e ndryshme (duke përfshirë ato që nuk janë ndjekur) (Neni 30 par. 2). Memorandumet shpjegues duhet t'i bashkëngjiten çdo dokumenti që nuk kërkon një koncept dokument, përveç nëse është i një natyre më të ulët (par. 5 i të njëjtës dispozitë).

47. Përveç kërkesave të përmendura më lart, Kryeministri, mbledhja e Qeverisë ose Komiteti i Ministrisë mund të kërkojnë nga Ministri që të ndër marrë konsultime publike për çdo çështje tjetër (neni 32 paragrafi 5).

48. Në rrethana të jashtëzakonshme të përcaktuara në nenin 16 të Rregullores së Qeverisë 5/2016, një projekt-politikë ose ligj do të miratohet pas një procedure të përshpejtuar, dhe pastaj nuk do t'i nënshtrohet konsultimeve publike. Kjo do të ndodhë vetëm në raste emergjencash, ose ku situata të tjera të jashtëzakonshme përcaktohen me ligj. Arsyet për zbatimin e procedurës së përshpejtuar do t'i komunikohen publikut nëpërmjet mjeteve të njoftimit të përcaktuara në Rregullore. Gjithashtu, sipas nenit 17, Rregullorja, dhe rrjedhimisht kërkesat dhe procedurat për konsultime publike, nuk do të zbatohet në lidhje me dokumentet jo-publike, të klasifikuara, marrëdhëniet ndërkombëtare dhe marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe, procedurat parlamentare në Kuvend, procedurat që përfshijnë miratimin e dekreteve presidenciale dhe të akteve administrative individuale (përveç nëse ligji parashikon ndryshe).

## **6. Si të angazhoheni në konsultime publike?**

### **6.1 Llojet e konsultimeve publike**

49. Neni 7 i Rregullores së Qeverisë Nr. 5/2016 liston disa lloje të formave dhe teknikave të konsultimit (por vë në dukje se konsultimet publike nuk duhet të kufizohen në këto):

- Konsultime me shkrim dhe elektronike
- Publikimi i draft-propozimit përkatës në faqen e internetit të qeverisë/ministrisë
- Takime publike
- Konferenca;
- Takime me grupet e interesit
- Punëtori

- Intervista/takime individuale
- Sondazhe të opinionit
- Votimi i diskutimit
- Panel (diskutime) me qytetarët
- Pika informative në rrugë

50. Siç është përcaktuar shprehimisht në Nenin 7, autoritetet publike mund të iniciojnë edhe forma të tjera të konsultimeve publike, p.sh. grupe punuese, konsultime në internet (duke përfshirë ueb-kaste, seminare online), debate përmes mediave ose rrjeteve sociale, mbledhje të përgjithshme (ndoshta më të përshtatshme për kontekstin komunal), ose mbledhje të informatave nga masa.

*Lloji i konsultimeve të zgjedhura do të varet nga tema e projekt-politikës apo ligjit, dhe cilat organizata apo grupe do të duhet të përfshihen në diskutime. Nëse një nga qëllimet e ushtrimit të konsultimeve është që të konsultohet me të rinjtë, për shembull, atëherë diskutimet intensive duhet të jenë të mundshme nëpërmjet internetit dhe mediave sociale; nëse është e rëndësishme për të diskutuar me të moshuarit, atëherë duhet të parashikohen mënyra të tjera për komunikim me ata, duke përfshirë sondazhe derë më derë, dhe radio- ose debate televizive.*

51. Rregullorja kryesisht bën dallimin mes dy formave kryesore të konsultimeve - mbledhjeve publike dhe konsultimeve me shkrim.

### **6.1.1 Mbledhjet publike**

52. Takimet publike të organizuara në kuadër të konsultimeve publike duhet t'u bëhen të ditur të gjithë pjesëmarrësve potencial të paktën 7 ditë kalendarike më herët (Neni 8 par. 1 i Rregullores së Qeverisë Nr. 5/2016). Organi publik që organizon ngjarjen do t'u japë palëve të interesuara dhe publikut kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur. Ftesa për ngjarje duhet të përmbajë së paku projekt propozimin dhe informacionin adekuat për të, si dhe kohën dhe vendndodhjen e mbledhjes, si dhe emrin e pikës së kontaktit (par. 2 të nenit 8). Organi publik do të drejtojë takimet dhe të mbajë procesverbalin e diskutimeve (par. 3) - pas një takimi, organi publik do të përgatisë një përmbledhje të diskutimeve dhe konkluzioneve, që do t'u shpërndahe të gjithë pjesëmarrësve (par. 4).

53. Sipas nenit 22 par. 1, takimet publike konsultative duhet të jenë të hapura për të gjitha palët e interesuara, pavarësisht se kush është ftuar të marrë pjesë – konfirmimi kërkohet vetëm për arsye logjistike (por jo për të përjashtuar pjesëmarrësit potencial). Mungesa e hapësirës fizike nuk duhet të jetë kurrë një arsye për të përjashtuar një palë të interesuar.

54. Palët e interesuara dhe anëtarët e publikut që marrin pjesë në takimet konsultative ose grupet e punës duhet të kenë qasje të barabartë në të gjitha informatat, materialet dhe të dhënat si të gjithë të tjerët që janë përfshirë në

hartimin e politikës/ligjit përkatës (neni 22 paragrafi 2). Përfaqësuesit e tyre do të jenë të lirë të informojnë palët dhe publikun që ata përfaqësojnë për punën e bërë dhe kontributet e tyre. Këta përfaqësues mundën gjithashtu lirisht të paraqesin dhe mbrojnë pozitat e tyre, si dhe të gjitha sugjerimet dhe komentet tjera të ngritura nga publiku dhe palët e tjera të interesuara; nëse ata janë pjesë e një grupi punues, ata mund të përdorin edhe mënyra të tjera për të avokuar ose promovuar pikëpamje që nuk janë në përputhje me pikëpamjet e grupit të punës.

55. Kur organet publike përgatisin planet e tyre të punës për vitin e ardhshëm, ato duhet t'u lejojnë palëve të interesuara dhe publikut të marrin pjesë në këtë (neni 13 par. 2), të paktën duke mbajtur takime publike gjatë të cilëve propozimet në projekt-planin e punës do të diskutohen, duke përfshirë së paku programet e politikave, strategjitë dhe legjislacionin e planifikuar për vitin e ardhshëm. Organet publike duhet gjithashtu të publikojnë planet finale të punës për vitin e ardhshëm, së bashku me çdo ndryshim të bërë.

56. Kur organet publike përgatisin propozime (për politika dhe/ose legjislative), ato gjithashtu duhet të përfshijnë palët e interesuara dhe publikun (neni 13 paragrafi 3), së paku duke organizuar një takim publik para fillimit të hartimit aktual të dokumentit. Gjatë këtij takimi do të diskutohen elementët kryesorë të propozimit të planifikuar, së bashku me arsyet për to, dhe organi organizues do t'u kërkojë palëve të interesuara dhe publikut të japin mendimet e tyre fillestare mbi propozimin e planifikuar. Pasi të jetë përgatitur drafti i parë i propozimit dhe pas konsultimeve me organet tjera publike, do të organizohet një procedurë e gjerë me shkrim për të mbledhur komentet mbi përmbajtjen e këtij dokumenti.

### **6.1.2 Konsultimet me shkrim**

57. Aty ku organi publik vendos të organizon konsultime me shkrim, ai u jep palëve të interesuara dhe anëtarëve të publikut kohë të mjaftueshme për të paraqitur komentet e tyre (të paktën 15 ditë pune) nga data kur është shpallur fillimi i periudhës së konsultimit (neni 9 par. 1 i Rregullores së Qeverisë Nr. 5/2016). Koha për paraqitjen e komenteve mund të zgjatet deri në 60 ditë kalendarike në total, për draft-propozimet që janë veçanërisht komplekse ose të rëndësishme. Ftesa për të marrë pjesë në konsultime publike me shkrim ka të njëjtat kërkesa për përmbajtje si për takime publike (shih nën-seksionin e mëparshëm), me kërkesa shtesë të shtuara, si adresa e paracaktuar dhe informata për afatin kohor (neni 9 par. 2).

58. Ftesa për konsultime me shkrim duhet gjithashtu të përfshijë një dokument konsultimi, i cili përbëhet nga një përmbledhje të përmbajtjes, një përshkrim të shkurtër të problemit, qëllimin e konsultimeve, dhe një listë të çështjeve kryesore që janë pjesë e dokumentit - detajet janë të përcaktuara në një shabllon që gjendet në Aneksin 1 të Rregullores.



59. Sipas nenit 14, afati kohor për kryerjen e konsultimeve me shkrim mund të zgjatet, ose konsultimet të përsëriten, nëse natyra e materialeve kërkon një periudhë më të gjatë konsultimi ose nëse organi propozues nuk ishte i kënaqur me cilësinë e komenteve të pranuar. E njëjta gjë vlen edhe kur komentet ose rekomandimet e marra nxjerrin çështje të reja të rëndësishme që nuk ishin pjesë e konsultimit fillestar.

## **6.2 Si të angazhoheni?**

60. Pasi të merren informatat relevante mbi konsultimet publike në vazhdim dhe ato të ardhshme, informata përkatëse duhet të analizohet. Në lidhje me politikat dhe ligjet e planifikuara, është e rëndësishme të pyesni veten disa pyetje kyçe, p.sh.:

- Lidhur me çka është draft-politika/ligji?
- Çfarë do të ndryshon? A do të ndryshon dokumentet e politikave/ligjeve aktuale?
- Kush do të preket nga këto ndryshime?
- A do të ndikojë në mënyrë jo-proporcionale (pozitive apo negative) në ndonjë person/grup personash?

Për pyetje më të hollësishme, ju lutem shihni Shtojcën 1 të këtij Udhëzuesi.

61. Kur diskutohen projekt-planet e punës, pyetjet që duhet të parashtrohen do të sillen më shumë rreth asaj nëse legjislativi i ri është vërtet i nevojshëm në fushën e specifikuar, ose nëse bërja prioritet e çështjeve ka kuptim.

62. Kur angazhoheni në konsultime publike, është e rëndësishme që palët e interesit dhe anëtarët e publikut të kenë kohë të mjaftueshme për të rishikuar projekt-propozimin dhe dokumentet e lidhura me të, dhe të formulojnë kontributin. Periudha e paralajmërimit prej shtatë ditësh para takimeve publike e përcaktuar në nenin 8 të Rregullores së Qeverisë Nr. 5/2016 mund të mos lejojë gjithmonë kohën e duhur të përgatitjes, veçanërisht nëse konsultimet kanë të bëjnë me draft-politika dhe ligje voluminoze dhe komplekse. Nëse është e mundur, është e rëndësishme që të përgatitet edhe për situata të tilla, p.sh. nëse dihet që do të bëhet një takim publik, leximi i legjislativit ekzistues relevant dhe i standardeve ndërkombëtare që supozohet se do të preken, duhet të ndodh paraprakisht.

63. Përderisa 15 ditët e përcaktuara për procedurat me shkrim në nenin 9 të Rregullores së Qeverisë Nr. 5/2016 nuk janë të gjata, është e rëndësishme të kujtojmë (dhe të avokojmë) se kjo është një periudhë minimale. Autoritetet publike, nëse dëshirojnë, mund të vendosin një afat më të gjatë, dhe ndoshta në disa raste duhet të inkurajohen dhe të kujtohen për ta bërë këtë. E rëndësishmja, nëse afati i caktuar perceptohet si tepër i shkurtër për të lejuar rishikimin dhe vlerësimin e duhur të një draft-propozimi, puna duhet të fillojë menjëherë, por nga organi publik përgjegjës ende mund të kërkohet një zgjatje e mundshme. Lidhur me formatin, modeli i Qeverisë i bashkëngjitur Rregullores gjithashtu përmban disa informata themelore mbi informatat

individuale që palët e interesit dhe anëtarët e publikut që kërkojnë të kontribuojnë në diskutimet mbi një draft-politikë ose ligj, duhet të dorëzojnë.

## **7. Kur të angazhoheni në konsultime publike?**

64. Autoritetet publike mund të vendosin të organizojnë konsultime publike në çdo pikë të procesit të hartimit të politikave ose ligjeve, varësisht nga kur ata besojnë se ato do të jenë më të dobishme. Kjo mund të jetë në fillim, kur është hartuar politika/ligji, ose më vonë, pasi politik-bërësit ose ligj-bërësit kanë zhvilluar pyetje më specifike për diskutim, ose më shumë se një herë në disa faza të ndryshme gjatë procesit të përgatitjes së politikave/ligjeve.

65. Për palët e interesuara dhe anëtarët e publikut, përvoja tregon se është mirë që të përpiqet dhe të angazhohet në diskutimet për një dokument të caktuar (draft-politikë ose ligj) sa më shpejt që të jetë e mundur, që të ketë një ndikim maksimal. Nëse komentet jepen shumë vonë në procesin e hartimit, atëherë organi publik përgjegjës nuk do të jetë i gatshëm të hapë tema që tashmë janë pajtuar me palët tjera të interesit, dhe nuk ka të ngjarë të pranohet kritika ndaj një teksti tashmë të zhvilluar mirë. Formulimi i Rregullores së Qeverisë Nr. 5/2016 gjithashtu zbulon një përpjekje për të përfshirë palët e interesuara dhe publikun në një fazë relativisht të hershme të diskutimeve.

## **8. Informatat kthyese, mbikëqyrja dhe raportimi**

66. Pas konsultimeve, organi propozues shqyrton komentet e mbledhura dhe vendos nëse do të pranojë ose refuzojë disa komente (Neni 15 i Rregullores së Qeverisë Nr. 5/2016). Organi propozues mund të vendosë për të ndryshuar draft-politikën ose ligjin në bazë të komenteve, dhe do të publikojë këtë version të ri të draft-propozimit në faqen të internetit, së bashku me një raport përfundimtar të përditësuar të konsultimeve të mbajtura. Ky raport përfundimtar do të bazohet në komentet e marra gjatë konsultimeve, dhe në mënyrën në të cilën ato janë adresuar. Nëse disa komente nuk janë marrë parasysh, atëherë raporti duhet të përshkruajë, së paku shkurtimisht, pse jo.

67. Pasi të publikohet raporti, është e rëndësishme për të gjithë pjesëmarrësit në konsultimet publike që të rishikojnë raportin, për të parë nëse komentet dhe kontributet që ata kanë ofruar gjatë konsultimeve janë adresuar. Ky lloj informatash kthyese është një element thelbësor i konsultimeve publike, dhe ndihmon në sigurimin e transparencës dhe efikasitetit të procesit. Kjo gjithashtu ndihmon në ndërtimin e besimit ndërmjet publikut dhe autoriteteve. Ndërsa është e natyrshme që jo të gjitha komentet (shpesh kontradiktore) të pranuar gjatë konsultimeve publike mund të përfshihen në projekt-politikën ose ligjin në diskutim, organet dhe individët e përfshirë së paku duhet të jenë në gjendje të shohin se shqetësimet e tyre janë shqyrtuar dhe diskutuar.

68. Përcjellja e ndikimit të punës së një personi do të jetë më e lehtë me komentet me shkrim, pasi lehtë mund të krahasohet dokumenti i hartuar gjatë konsultimeve me tekstin e raportit të lëshuar. Do të jetë më e vështirë të

gjurmohen komentet dhe kontributet e dhëna gjatë një takimi publik apo ngjarjeve të tjera - në këto raste, mund të jetë e dobishme të dërgoni komente me shkrim pas kontributit verbal të dhënë gjatë takimit. Edhe nëse mbahen procesverbale nga organi publik që organizon ngjarjen, deklaratat mund të shkurtohen ose paraqiten keq, kështu që këto lloje 'reklamimesh' mund të sigurojnë që asnjë nga komentet dhe kontributet e dhëna të mos humbasin.

69. Zyrtarët përgjegjës për organizimin e konsultimeve publike brenda organeve publike janë në thelb ata që hartojnë një politikë ose ligj. Mënyra e organizimit dhe zbatimit të konsultimeve publike mbikëqyret nga departamentet ligjore nga i njëjti organ publik (neni 19 par. 1 i Rregullores së Qeverisë Nr. 5/2016). Departamenti përgjegjës për politika dhe integrimin evropian do të bëjë të njëjtën gjë edhe për draft koncept-dokumentet dhe draft-dokumentet strategjike (neni 19 paragrafi 2).

70. Pasi që draft-propozimi të jetë dorëzuar për miratim nga Qeveria, zyrat kompetente brenda Zyrës së Kryeministrit do të shqyrtojnë nëse, brenda fushëveprimit të tyre, draft-politika/ligji është në pajtim me standardet minimale të konsultimeve publike. Nëse ata kanë gjetur se konsultimet publike nuk janë mbajtur në përputhje me Rregulloren, këto zyra mund të refuzojnë draft-propozimin dhe të kërkojnë nga organi publik përkatës që të shqyrtojë çështjen dhe të zbatojë standardet minimale për konsultime publike (kjo do të thotë me siguri që konsultimi publik do të duhet të përsëritet) (Neni 19 par. 3).

71. Nëse palët e interesuara, ose anëtarët e publikut besojnë se organi publik që ka organizuar konsultime publike ka shkelur të drejtën e tyre për konsultime publike në pajtim me Rregulloren e Qeverisë Nr. 5/2016, ata mund të bëjnë kërkesë me shkrim organit kompetent të monitorimit<sup>8</sup>, dhe të kërkojnë nga ai që të ndërmerr veprimet e duhura në përputhje me Rregulloren (neni 19 paragrafi 5 i Rregullores).

72. Për sa i përket raportimit të përgjithshëm, zyrtari përgjegjës për koordinimin e konsultimeve publike brenda organit publik duhet të përgatisë një raport vjetor mbi mënyrën se si organi i tij/saj përkatës publik ka kryer konsultimet publike në atë vit të veçantë, i cili i dorëzohet Zyrës për Qeverisje të Mirë brenda Zyrës së Kryeministrit. Ky raport do të bazohet në raportet e përgatitura për çdo ushtrim të konsultimeve publike. Zyra për Qeverisje të Mirë, bazuar në raportet e marra nga të gjitha organet publike, do të krijojë një raport përfundimtar vjetor që do të ofron informata për të gjitha konsultimet publike të kryera nga organet e ndryshme publike brenda vitit përkatës, të cilin do ta publikon deri më 31 mars të vitit vijues.

73. Në mënyrë ideale, një raport i tillë përfundimtar mund të jetë një pikënisje e mirë për diskutimet se si janë kryer konsultimet publike në vitin e kaluar, dhe nëse ato janë përgatitur dhe ndërmarrë në mënyrë efektive, të hapur dhe transparente. Çdo shqetësim i përgjithshëm lidhur me konsultimin publik të

---

<sup>8</sup> Përderisa Rregullorja e Qeverisë Nr. 5/2016 nuk e specifikon këtë procedurë, personat ose OJQ-të që dëshirojnë të paraqesin një ankesë sipas nenit 19 par. 5, mund ta bëjnë këtë duke kontaktuar personin përgjegjës për konsultimin publik përkatës përmes platformës online për konsultime publike të Qeverisë (shih par. 34 të Udhëzuesit), ose, nëse kjo nuk funksionon, duke kontaktuar drejtpërsëdrejti Zyrën për Qeverisje të Mirë brenda Zyrës së Kryeministrit.

draft-propozimeve mund të debatohet publikisht në këtë kohë, me qëllim që të sigurohet që proceset e konsultimit publik të kryera në vitin e ardhshëm do të jenë më të mira në aspektin e pjesëmarrjes, përmbajtjes dhe rezultateve.

## **9. Krijimi i rrjeteve dhe koalicioneve për të përmirësuar ndikimin**

74. Me qëllim të rritjes së ndikimit publik mbi projekt-politikat dhe ligjet, mund të jetë e dobishme të krijohen rrjete, koalicione, platforma jo-formale ose partneritete të institucioneve të ndryshme të shoqërisë civile dhe pjesëve të publikut në lidhje me fushat specifike tematike, ose draft-propozimet. Kjo mund të ndihmojë të sigurohet që organizata të ndryshme të shoqërisë civile që punojnë në të njëjtat tema do të jenë të informuara dhe të përfshira në mënyrë të barabartë, gjë që do të krijonte shumë përfitime për cilësinë dhe shumëllojshmërinë e diskutimeve.

75. Në veçanti, kjo mund të ndihmojë në ngritjen e vetëdijes për çështje të caktuara edhe jashtë zonave urbane, dhe mund të lehtëson pjesëmarrjen publike të individëve dhe organizatave edhe nga këto fusha. Për më tepër, sa më shumë organizata dhe individ të përfshihen, dhe të përpiqen të ndikojnë në projekt-propozime në fusha të caktuara, aq më i madh është ndikimi.

## **10. Diversiteti dhe çështjet gjinore**

76. Kur debatohen ndikimet e projekt-propozimeve mbi publikun, është e rëndësishme të vlerësohen edhe ndikimet që ato do të kenë në jetën dhe aktivitetet e komuniteteve individuale. Në disa fusha, politika ose legjislacione të tilla mund të ndikojnë në komunitete të ndryshme në mënyrë tjetër, dhe është e rëndësishme të shmanget një ndikim i tillë negativ në disa komunitete.

77. Organizatat që mbrojnë të drejtat e komuniteteve të caktuara duhet të kenë mundësi të barabarta për të marrë pjesë në debate të tilla dhe duhet të ngrenë shqetësime nëse ndeshen me ndonjë situatë ku ata përjashtohen ose trajtohen ndryshe nga organizatat e tjera. Megjithatë, pasi politikat dhe ligjet nuk duhet të diskriminojnë, është gjithashtu e rëndësishme për organizatat tjera që t'i vlerësojnë ato në këtë kontekst, dhe të ngrenë zërin e tyre nëse zbulohet një pabarazi e tillë.

78. Draft-propozimet duhet gjithashtu të vlerësohen për çdo pabarazi gjinore – kjo do të thotë se ndikimi i ndryshëm i politikave/legjislacionit mbi burrat dhe gratë duhet gjithashtu të jetë pjesë e shqyrtimit të përgjithshëm të projekt-propozimeve. Nëse, për shembull, disa projekt-propozime përmbajnë dispozita që i trajtojnë gratë ndryshe nga burrat (ose anasjelltas), ose që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë do të dëmtojnë gratë apo burrat, atëherë kjo duhet të ngritet dhe debatohet gjatë konsultimeve publike.

## **V. SI TË SIGUROHEN KONSULTIMET PUBLIKE PËR PROJEKT-LIGJET E INICIUAR NGA 10 000 QYTETARË**

79. Siç përshkruhet në Nën-seksionin III të Seksionit të mëparshëm, Kushtetuta dhe Ligji për Nismat Legjislative u lejojnë 10 000 qytetarëve që të iniciojnë legjislacion (ose duke përgatitur vetë projektligjin, ose duke kërkuar nga Kuvendi që ta përgatisë atë).

80. Si hap i parë për këtë, organizatorët e iniciativës duhet të gjejnë 10 000 persona të gatshëm për të nënshkruar iniciativën e tyre, gjë që do të kërkojë një sasi të madhe të konsultimeve publike dhe ngritjes së vetëdijes. Në veçanti, organizatorët e iniciativës duhet të fillojnë duke i komunikuar publikut qëllimet dhe elementet kryesore të projektligjit të planifikuar. Ata do të duhet t'i komunikojnë këto në mënyrë të qartë dhe të jenë shumë të saktë në atë se çka do të ndryshojë ligji i ri, dhe pse kjo do të ishte e nevojshme, dhe pse kjo duhet të favorizohet mbi drejtimit tjerë të mundshëm të veprimit.

81. Ndërsa këto lloje të iniciativave nuk do të ndodhin shumë shpesh, është e rëndësishme që organizatorët të planifikojnë përpara, të vendosin për mjetet më të mira të konsultimit me publikun dhe palët e interesit, dhe të dalin me mjete efektive për të siguruar ndihmën dhe për të mbledhur të dhëna. Çështjet dhe hapat procedural të mësipërm duhet të mbahen parasysh nga organizatorët.

## **SHTOJCA 1:**

*Pyetje të mundshme për të shtruar kur angazhoheni në konsultime publike mbi projekt-politika dhe ligje*

### **Pajtueshmëria me Kushtetutën/kornizën ligjore**

1. A prekë çështja kryesore e projekt-politikës/ligjit ndonjë nga të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë?
2. A prekë çështja kryesore e projekt-politikës/ligjit ndonjë nga të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga instrumentet ndërkombëtare që janë të zbatueshme drejtpërdrejt në Kosovë, në pajtim me nenin 22 par. 3 të Kushtetutës?
3. A është projekt-politika/ligji në përputhje me ligjet ekzistuese (përveç me politikën/ligjin ekzistues që synon ta zëvendësojë ose ta ndryshojë)? Nëse jo, a parashih projekt-politika/ligji që t'i ndryshojë ato?
4. A kundërshton ndonjë dispozitë e projekt-politikës/ligjit ndonjë dispozitë tjetër të dokumentit të njëjtë?
5. A mbesin projekt-aktet nënligjore brenda kufijve të asaj që është e lejuar sipas akteve ekzistuese ligjore?

### **Nevoja për projekt-politikën/ligjin**

6. Çfarë synon të arrijë projekt-politika/ligji? A është kjo mënyra më e mirë për ta arritur atë? Apo ekzistojnë edhe mundësi tjera (p.sh. zbatim më i mirë i legjislacionit ekzistues, fushata për ngritjen e vetëdijes, thjesht duke mos bërë asgjë).
7. Cilat mundësi të tjera janë vlerësuar për të arritur të njëjtin qëllim? A është shpjeguar opsioni i zgjedhur (dm.th. projekt-politika/ligji i tanishëm), dhe a është bindës arsyetimi për këtë opsion të veçantë?
8. A ka ndonjë mundësi tjetër për të arritur qëllimin që nuk është marrë parasysh, apo nuk është vlerësuar siç duhet?

### **Efektet e projekt-politikave/ligjeve**

9. Cilat janë efektet pozitive të projekt-politikave/ligjit? Cilat janë efektet e tyre negative?
10. Kur balancohen këto efekte, a peshojnë efektet pozitive më shumë se ato negative?
11. A janë individë ose grupe individësh të caktuar veçanërisht të prekur nga projekt-politika/ligji (pozitivisht apo negativisht)? A trajtohen njerëzit në situata të njëjta ose të ngjashme në mënyrë të ndryshme? A mund të arsyetohet ky ndryshim në trajtim?
12. A ndikon projekt-politika/ligji në të njëjtën mënyrë në burrat dhe gratë? Nëse jo, a ka efekte veçanërisht negative vetëm për gratë, apo vetëm për

- burrat? A kanë autoritetet përgjegjëse sugjerime për të balancuar këtë pabarazi?
13. A kanë përcaktuar autoritetet përgjegjëse publike efektet e mundshme (pozitive dhe negative) gjatë konsultimeve publike?
  14. Çfarë lloj shpenzimesh do të shkakton në mënyrë reale zbatimi i projekt-politikës/ligjit? A u janë shpjeguar këto palëve të interesit/publikut, dhe a janë ndarë paratë publike në përputhje me rrethanat? A kanë marrë parasysh hartuesit kostot e mundshme për ngritje të vetëdijes dhe/ose trajnime?
  15. A përcaktojnë dispozitat përfundimtare dhe ato kalimtare nga projekt-politika/ligji se si dhe kur do të hyn në fuqi?

### ***Gjuha dhe struktura***

16. A është hartuar politika/ligji në një mënyrë të qartë dhe të kuptueshme? A e kuptojnë individët se si do të ndikojnë ato në jetën e tyre të përditshme nga teksti i projekt-politikës/ligjit?
17. A përcakton projekt-politika/ligji se cili organ/organe do të jetë përgjegjës për zbatimin e politikës/ligjit?
18. Në rastet kur një projektligj përmban sanksione, a parashikojnë qartë dispozitat përkatëse se cila sjellje nuk lejohet, dhe cila lloj sjelljeje do të përmbushet me cilin sanksion?
19. A është publikuar drafti i politikës/ligjit në të gjitha gjuhët zyrtare të Kosovës? A janë të gjitha versionet të një cilësie adekuate dhe të kuptueshme?
20. A përdor projekt-politika/ligji një gjuhë neutrale gjinore?

### ***Transparenca dhe ngritja e vetëdijes***

21. A janë të vetëdijshëm publiku dhe shoqëria civile për projekt-politikën/ligjin dhe përmbajtjen e saj?
22. A janë personat që pritet të zbatojnë projekt-politikat/ligjet, apo ata që do të preken nga projekt-politikat/ligjet, të vetëdijshëm për përmbajtjen e tyre?
23. A ka kryer Ministria/agjencia përgjegjëse një komunikim për të siguruar ndërgjegjësimin e publikut/palëve të interesit për projekt-politikat/ligjet?
24. A janë informuar palët e interesit dhe publiku për konsultimet e ardhshme publike në kohë? A është sqaruar procesi dhe informacioni që po kërkohet?



INICIATIVA KOSOVARE  
PËR STABILITET

KOSOVAR STABILITY  
INITIATIVE